



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.1021/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Blerim Dina – Kryetar, panelist individual, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “DHW Kosova” SH.P.K-Prishtinë, kundër dokumenteve të tenderit (njoftimit për kontratë), lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ri-shpallje furnizim me pajisje të instrumentit GPS dhe Total Station” me nr. të prokurimit: 632-20-7318-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- “KK-Gjakovë”, më datën: 23.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “DHW Kosova” SH.P.K-Prishtinë, kundër dokumenteve të tenderit (njoftimit për kontratë), lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ri-shpallje furnizim me pajisje të instrumentit GPS dhe Total Station” me nr. të prokurimit: 632-20-7318-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- “KK-Gjakovë”,

II. OBLIGOHET, autoriteti kontraktues “KK-Gjakovë” ti bëj ndryshimet e specifikimeve teknike në pajtim me dispozitat ligjore dhe të zgjasë afatin për ofertë duke vepruar konform nenit 53.7 të LPP-së, dhe të marrë parasysh rekomandimet e dhëna në raportin e ekspertizës lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ri-shpallje furnizim me pajisje të instrumentit GPS dhe Total Station” me nr. të prokurimit: 632-20-7318-1-2-1.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “DHW Kosova”SH.P.K-Prishtinë, i aprovohet si pjesërisht e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues DHW Kosova”SH.P.K-Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 27.11.2020 me nr. 1021/20, kundër dokumenteve të tenderit (njoftimit për kontratë), lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ri-shpallje furnizim me pajisje të instrumentit GPS dhe Total Station” me nr. të prokurimit: 632-20-7318-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-“KK-Gjakovë”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 2, 3, 7 dhe 28 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 01.12.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 07.12.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Sqarim hyrës: Fillimisht sqarojmë se pretendimet ankimor të paraqitura në këtë ankesë kanë të bëjnë me dokumentet e tenderit, përkatësisht specifikimet teknike. OE ankues ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së me datë 13.11.2020 me pretendime të njëjta ankimore sikurse në këtë ankesë. AK me datë 23.11.2020 ka nxjerr vendim me të cilin refuzon kërkesën për rishqyrtim. Duke marrë për bazë që pretendimet ankimore janë të ngjashme me pretendimet e aktivitetet paraprak, konform vendimeve paraprake janë dhënë sqarimet e detajuara sipas pretendimeve si vijon:

Përgjigje në Pretendimin Ankimor numër 1

OE ankues pretendon se AK ka bërë shkelje të dispozitave të LPP-së duke vendosur kërkesa që

favorizojnë vetëm një prodhues, në këtë rast sistemin operativ Windows dhe duke diskriminuar pajisjet që kanë sisteme tjera operative sikurse janë Android dhe IOS. Ashtu sikurse është sqaruar dhe vendosur në ankesën 458/20, prodhues të ndryshëm të këtyre pajisjeve sipas hulumtimit nuk përmbushin kërkesat e tilla, rrjedhimisht kërkesat e tilla bien në kundërshtim me dispozitat e LPP-së ku ndalohen kërkesat apo specifikimet që reduktojnë apo eliminojnë konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminojnë në dëm ose në të mirë të një ose më shume operatorëve ekonomik. Aq me tepër kur kërkesa për sistem operativ nuk limiton në funksionet e AK-së për mbledhjen dhe shkëmbimin apo bartjen e të dhënave në pajisje tjera sikurse mund të jenë kompjuterët e zyrës. AK në arsyetimin e vendimit për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim fjalën ekuivalente të vendosur në specifikime e ngushton në sisteme vetëm të Windows. Pra sistemet paraprake si Windows 8, 7. Ky konstatim nuk është në përputhje me sqarimet e dhëna paraprake në lidhje me këtë çështje, sepse ashtu sikurse është sqaruar në ekspertizën dhe vendimin e Panelit Shqyrtues me numër 458/20, kërkesa për sistemin operativ duhet të përfshijë edhe sistemet tjera operative ekuivalent me kusht që të mundësojë komunikimin dhe bartjen e të dhënave në pajisje me sistemin operativ Windows 10. Në këtë formë AK sigurohet që pajisja me të cilën furnizohet i përmbush nevojat e institucionet dhe zgjerohet konkurrenca në këtë aktivitetet të prokurimit. Sipas sqarimit të mësipërm pretendimi ankimor në këtë pikë është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimin Ankimor numër 2

OE ankues po ashtu pretendon se AK ka vendosur specifikime diskriminues edhe për memorien e brendshme, kështu duke kërkuar memorie me kapacitet 64 GB përjashton pajisjet e prodhuesit të cilin OE e përfaqëson dhe prodhuesit tjerë. AK në dosjen e tenderit, respektivisht në paramasë ka paraqitur specifikimet teknike, ku ndër të tjera ka përcaktuar “ hapësirë memorizuese (ruajtja e të dhënave) jo me e vogël se 64 GB”. Si i tillë formulimi nuk përcakton se hapësira memorizuese është vetëm memorie e brendshme. Megjithatë, në lidhje me kapacitetin e diskut apo hapësirën memorizuese OE ankues në kërkesën për rishqyrtim ka paraqitur pretendimin e njëjtë si në këtë ankesë dhe sipas sqarimeve të dhëna nga AK në arsyetimin e dhënë në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, AK thekson se vetëm sistemi operativ kërkon kapacitet 22-25 GB. AK në ankesat paraprake është arsyetuar se kërkesa 64 GB ka qenë për shkak se është e nevojshme për ruajtjen e të dhënave nga matjet në teren dhe pastaj bartjet në kompjuter. Ashtu sikurse e kemi sqaruar më herët, kjo do të mund të bëhej edhe nëse pajisja ka memorie të brendshme me të vogël sikurse është potencuar edhe më parë shembull 32GB e cila është e mjaftueshme për të gjithë sistemet operative dhe duke u plotësuar me memorie të jashtme e cila do të mundësonte transferimin të të dhënave në kompjuter apo pajisje tjera. Kjo kërkesë ka ndërlidhje edhe me kërkesën për sistem operativ për shkak se sistemet e ndryshme kanë kërkesa të

ndryshme për hapësirë për sistemin operativ. Zgjidhja gjithëpërfshirëse dhe që përmbushë në të njëjtën kohë kërkesën për kapacitet 64 GB është që AK të kërkojë hapësirë memorizuese 64 GB në total, e që përfshinë memorien e brendshme të nevojshme për sistemin operativ që ofertohet dhe memory card që mund të plotësojë kapacitetin e kërkuar gjithsej 64 GB. Andaj, pretendimi ankimor në këtë pikë është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimin Ankimor numër 3

Në fund OE ankues pretendon po ashtu se kërkesa për IP 68 për kontrollorin është kërkesë e lartë dhe si e tillë është diskriminuese pasi që nuk mund të plotësohet nga me shumë se një prodhues. Në bazë të kërtimeve të bëra në ueb faqet e prodhuesve të pajisjeve kontrollor që mbledhin të dhënat e matjeve, është evidente se disa prodhues dhe pajisjet e tyre (kontrollerë) nuk përmbushin kërkesën për standardin IP 68, konkretisht kanë nivelin 67 dhe 66. Disa nga prodhuesit dhe kontrollerët që nuk plotësojnë këtë standard apo kanë standard me të ulët janë www.geospatial.trimble.com; www.geomax-positioning.com; www.leica-geosystems.com/. Si përfundim ashtu sikurse e ka potencuar AK në arsyetimin e vendimit për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim standardi i kërkuar është maksimal që ofrohet në treg. Andaj si i tillë përjashton me shumë se një prodhues dhe pajisje të tillë. Andaj, pretendimi ankimor në këtë pikë është i bazuar. Sikurse është sqaruar më sipër në tri pretendimet ankimore, specifikimet teknike dhe sqarimet e AK-së janë në kundërshtim me Nenin 7 dhe 28 të LPP-së, për shkakun se ashtu sikurse janë formuluar dhe sqaruar nga AK, reduktojnë apo eliminojnë konkurrencën në mes të OE ose diskriminojnë në dëm ose në të mirë të një ose më shumë OE, përkatësisht nuk janë të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë OE dhe tenderuesit e interesuar për këtë aktivitet të prokurimit.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e cekura në raport, Eksperti Shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE “DHW Kosova” SH.P.K, të aprovohet si pjesërisht e bazuar. Më tej propozohet që të obligohet AK të bëjë korrigjimet sipas sqarimeve të dhëna më lartë dhe të bëhet zgjatja e afatit për dorëzimin e ofertave konform dispozitave të LPP-së.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 07.12.2020 me raportin e ekspertizës.

Operatori Ekonomik: “DHW Kosova” SH.P.K - Prishtinë, me datë: 08.12.2020, me anë të parashtresës , ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Përgjigja e OSHP1021/20, date 07.12.2020

E nderuar OSHP,ne, konfirmojmë marrjen e raportit te Ekspertit Shqyrtues 1021/20, date 07.12.2020. Ne - duke qene qe kemi një eksperience te gjate ne përballjet tona ne OSHP, dhe jo për fajin dhe/ose meritën tone - jemi te surprizuar nga raporti i Ekspertit Shqyrtues, por kësaj radhe si asnjë here tjetër pozitivisht. Ne, jemi përballur me një numër te madh ESH, te cilët ndodhen ne listën e OSHP, dhe me keqardhje kemi vene re, qe shumica e ESH, te angazhuar ne qeshtjet tona, i qasen problematikes se ankimimit te OE nga vetvetja dhe jo nga LPP.

Z. Spahiu, është i pari, dhe i vetmi ESH, ne eksperiencën tone, qe i qaset problematikes nga LPP. Ai, ne këtë analize, njësohet me LPP si fryme dhe germe dhe çdo pike te ankimimit e vendos ne planin ligjor si fryme dhe germe, duke nxjerre ne pah ne mënyrë te thjeshte dhe elokuyente përputhjen ose jo te kërkesës se AK me bazën ligjore. Këtë ka pasur edhe ligjvënësi parasysh, kur ka parapare angazhimin e një eksperti shqyrtues. Pra një specialist te fushës, i cili kërkesën teknike e sheh dhe vlerëson nga fryma dhe perspektiva e ligjit, ne ndihme te trupës gjykuese.

ESH, e ka shtyre edhe me tej analizën e tij - dhe për këtë ka merite te veçante - pasi e ka shtrire analizën edhe ne historikun e vet paraprak, ku me te drejte ve ne dukje, qe kërkesa e AK, është konstante ishte dhe mbi ligjin. OSHP e ka rrezuar, ne mënyrë te përsëritur ne vendimet e saj, AK, por AK vazhdon ti kundërvihet vendimeve te OSHP, duke mos ndryshuar asgjë ne kërkesën e vet?! ESH nxjerr ne pah, edhe pse me elegance nuk e nënvizon me fjale, përmbysjen e roleve ndërmjet OSHP dhe AK. Nuk kuptohet kush gjykon ke?! Chapeau! Me këtë analize ESH, ka nënvizuar edhe një problematike tjetër, mjaft te rëndësishme, mos përballja e AK me vendimet e OSHP (pika IV), kur ato nuk respektohen. Ky mosndëshkim i AK - kjo është një plage e rende ne analet e OSHP - ka stimuluar mosrespektimin e vendimeve te OSHP prej AK-se. Rasti i KK Gjakove është unik ne analet e legjislacionit, jo vetëm te RK, por me siguri edhe ne evidencat botërore: 9 vendime te OSHP (pa llogaritur 1021/20), për tre vjet, për te njëjtin objekt, te gjitha rrezuese për AK. Ky rast duhet ti referohet me paqetë organeve qe merren me zbatimin e ligjit nga entet publike, si dhe katedrave te jurisprudencës. Ne mbyllje, ne pranojmë analizën, përfundimet dhe rekomandimet e raportit 1021/20 te ESH, dhe presim qe me se fundi, pas me shume se 9 vendimeve te OSHP, AK (KK Gjakove) te përballlet me mosrespektimin e vendimit te OSHP 458/20, pika IV, si dhe mosrespektimin e vendimeve te mëparshme. Prokurimit te KK Gjakove, dikush duhet të ja bej te ditur, qe ligji është i zbatueshëm për te gjithë, dhe KK Gjakove, nuk është pjese ekstra territoriale e Republikës se Kosovës, dhe nuk gëzon status te veçante. Ne fund, por jo si te fundit, ne e dimë qe individë te caktuar ne prokurimin e KK Gjakove, pavarësisht vendimit te OSHP 1021/20, ja kane dale, si gjithnjë te realizoje deri diku planet e veta, ne mos planin A, ata kane realizuar planin B "nëse nuk e merr tenderin OE i përzgjedhur (plani A), nuk e merr asnjë OE tjetër (plani B)". Dhe kjo është bere e mundur, sepse ndaj tyre nuk

është zbatuar asnjë here pika IV e vendimeve të OSHP. A do vazhdoje ky mosndëshkim edhe kësaj radhe? Kjo është pyetja prej 1 mi. EURO. Përshëndetje institucionale
Selvete Gagic, Office Manager.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 23.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtrirat e palëve në procedurë.

OE ankues pretendon se AK ka bërë shkelje të dispozitave të LPP-së duke vendosur kërkesa që favorizojnë vetëm një prodhues, në këtë rast sistemin operativ Windows dhe duke diskriminuar pajisjet që kanë sisteme tjera operative sikurse janë Android dhe IOS.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik sqaron se ashtu sikurse është sqaruar dhe vendosur në ankesën 458/20, prodhues të ndryshëm të këtyre pajisjeve sipas hulumtimit nuk përmbushin kërkesat e tilla, rrjedhimisht kërkesat e tilla bien në kundërshtim me dispozitat e LPP-së, ku ndalohen kërkesat apo specifikimet që reduktojnë apo eliminojnë konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminojnë në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomik. Aq më tepër kur kërkesa për sistem operativ nuk limiton në funksionet e AK-së për mbledhjen dhe shkëmbimin apo bartjen e të dhënave në pajisje tjera sikurse mund të jenë kompjuterët e zyrës. AK në arsyetimin e vendimit për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim fjalën ekuivalente të vendosur në specifikime e ngushton në sisteme vetëm të Windows. Pra sistemet paraprake si Windows 8, 7. Ky konstatim nuk është në përputhje me sqarimet e dhëna paraprake në lidhje me këtë çështje, sepse ashtu sikurse është sqaruar në ekspertizën dhe vendimin e Panelit Shqyrtues me numër 458/20, kërkesa për sistemin operativ duhet të përfshijë edhe sistemet tjera operative ekuivalent me kusht që të mundësojë komunikimin dhe bartjen e të dhënave në pajisje me sistemin operativ Windows 10. Në këtë formë AK sigurohet që pajisja me të cilën furnizohet i përmbush nevojat e institucionet dhe zgjerohet konkurrenca në këtë aktivitetet të prokurimit. Sipas sqarimit të mësipërm pretendimi ankimor në këtë pikë është i bazuar.

OE ankues po ashtu pretendon se AK ka vendosur specifikime diskriminues edhe për memorien e brendshme, kështu duke kërkuar memorie me kapacitet 64 GB përjashton pajisjet e prodhuesit të cilin

OE e përfaqëson dhe prodhuesit tjerë. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik sqaron se AK në dosjen e tenderit, respektivisht në paramasë ka paraqitur specifikimet teknike, ku ndër të tjera ka përcaktuar “ hapësirë memorizuese (ruajtja e të dhënave) jo më e vogël se 64 GB”. Si i tillë formulimi nuk përcakton se hapësira memorizuese është vetëm memorie e brendshme. Megjithatë, në lidhje me kapacitetin e diskut apo hapësirën memorizuese OE ankues në kërkesën për rishqyrtim ka paraqitur pretendimin e njëjtë si në këtë ankesë dhe sipas sqarimeve të dhëna nga AK në arsyetimin e dhënë në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, AK thekson se vetëm sistemi operativ kërkon kapacitet 22-25 GB. AK në ankesat paraprake është arsyetuar se kërkesa 64 GB ka qenë për shkak se është e nevojshme për ruajtjen e të dhënave nga matjet në teren dhe pastaj bartjet në kompjuter. Ashtu sikurse e kemi sqaruar më herët, kjo do të mund të bëhej edhe nëse pajisja ka memorie të brendshme me të vogël sikurse është potencuar edhe më parë shembull 32GB e cila është e mjaftueshme për të gjithë sistemet operative dhe duke u plotësuar me memorie të jashtme e cila do të mundësonte transferimin të të dhënave në kompjuter apo pajisje tjera. Kjo kërkesë ka ndërlidhje edhe me kërkesën për sistem operativ për shkak se sistemet e ndryshme kanë kërkesa të ndryshme për hapësirë për sistemin operativ. Zgjidhja gjithëpërfshirëse dhe që përmbushë në të njëjtën kohë kërkesën për kapacitet 64 GB është që AK të kërkojë hapësirë memorizuese 64 GB në total, e që përfshinë memorien e brendshme të nevojshme për sistemin operativ që ofertohej dhe memory card që mund të plotësojë kapacitetin e kërkuar gjithsej 64 GB. Andaj, pretendimi ankimor në këtë pikë është i bazuar.

Në fund OE ankues pretendon po ashtu se kërkesa për IP 68 për kontrollorin është kërkesë e lartë dhe si e tillë është diskriminuese pasi që nuk mund të plotësohet nga me shumë se një prodhues. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik sqaron se në bazë të kërkimeve të bëra në ueb faqet e prodhuesve të pajisjeve kontroller që mbledhin të dhënat e matjeve, është evidente se disa prodhues dhe pajisjet e tyre (kontrollerë) nuk përmbushin kërkesën për standardin IP 68, konkretisht kanë nivelin 67 dhe 66. Disa nga prodhuesit dhe kontrollerët që nuk plotësojnë këtë standard apo kanë standard me të ulët janë www.geospatial.trimble.com; www.geomax-positioning.com; www.leica-geosystems.com/. Si përfundim ashtu sikurse e ka potencuar AK në arsyetimin e vendimit për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim standardi i kërkuar është maksimal që ofrohet në treg dhe si i tillë përjashton me shumë se një prodhues dhe pajisje të tillë. Andaj, pretendimi ankimor në këtë pikë është i bazuar.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues/teknik, sqaron se

sikurse është sqaruar në tri pretendimet ankimore, specifikimet teknike dhe sqarimet e AK-së janë në kundërshtim me nenin 7 dhe 28 të LPP-së, për shkakun se ashtu sikurse janë formuluar dhe sqaruar nga AK, reduktojnë apo eliminojnë konkurrencën në mes të OE ose diskriminojnë në dëm ose në të mirë të një ose më shumë OE, përkatësisht nuk janë të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë OE dhe tenderuesit e interesuar për këtë aktivitet të prokurimit. Andaj, obligohet AK që ti merr parasysh rekomandimet e dhëna në raportin e ekspertit dhe udhëzimet në këtë vendim.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK "KK-Gjakovë";
- 1x1 OE "DHW Kosova" SH.P.K-Prishtinë;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.